

Më  
Dana

04 - 06 - 2018

P.nr.1063/17

## NË EMËR TË POPULLIT

### GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ- Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni

Penal, si gjykatë e shkallës së parë penale, gjyqtarit Elmaz Zenuni me zyr.ligjor Gazmend Bytyqi, në çështjen penale kundër të pandehurve: 1. [REDACTED], 2. [REDACTED] dhe 3. [REDACTED] që të tre nga Ferizaji, Rruga " [REDACTED]" nr. [REDACTED], për shkak të veprës penale në bashkëkryerje lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.47-4/2016 të dt.25.04.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor më datën 25.04.2018 në praninë e prokurorit të shtetit Valdet Avdiu, të pandehurve, të njejtën ditë morri dhe publikishtë shpalli këtë

### A K T G J Y K I M

Të pandehurit:

1. [REDACTED], nga Ferizaji, Rruga ' [REDACTED]' nr. [REDACTED] i lindur me dt. [REDACTED] në fshatin [REDACTED] të Shtimes, nga i ati [REDACTED] dhe eëma [REDACTED] e vajzërisë [REDACTED], ka të kryer shkollën e mesme, me profesion murator, i martuar baba i 4 (katër) fëmijëve, i gjendjes së varfér ekonomike, shqiptar, shtetase e Republikës së Kosovës,
2. [REDACTED], nga Ferizaji, Rruga ' [REDACTED]' nr. [REDACTED] i lindur me dt. [REDACTED] në Ferizaj, nga i ati [REDACTED] dhe eëma [REDACTED] e vajzërisë [REDACTED], ka të kryer shkollën e mesme, pa punë, i pa martuar, i gjendjes së varfér ekonomike, shqiptar, shtetase e Republikës së Kosovës,
3. [REDACTED], nga Ferizaji, Rruga ' [REDACTED]' nr. [REDACTED] i lindur me dt. [REDACTED] në Ferizaj, nga i ati [REDACTED] dhe eëma [REDACTED] e vajzërisë [REDACTED], ka të kryer shkollën e mesme, me profesion murator, i pa martuar, i gjendjes së varfér ekonomike, shqiptar, shtetase e Republikës së Kosovës,

## JANË FAJTORË

Sepse me datën 04.01.2016, rrëth orës 15:20, në Rrugën "Hamëz Jashari" në Ferizaj të pandehurit hyjnë në kafiterinë "Lenita" në Ferizaj dhe me forcë e nxjerrin nga kafiteria të dëmtuarin [REDACTED] dhe më pas e godasin me grushta në fytyrë dhe pjesë të tjera të trupit, pasi që i dëmtuarit ua kishte një borgj, me ç, rast të dëmtuarit i kanë shkaktuar lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohëshme për shëndetin, të përshkruara në Ekspertizën mjeko ligjore të dt. 19.09.2016,-

**Me këte ka kryer vepren penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.**

Andaj, Gjykata, në kuptim të nenit 188 par.1 enenit 31 të KPRK-së, dhe neneve 4, 7, 8 par.1, 9, 10 par.1, 17 par.1, 21 par.1 dhe 2, 41, 42 par.1 nënparr.1.1, 43 par.1 nënparr.1.2 dhe 1.3, 45, 46, 47, 73, 74, të KPRK-së, si dhe nenit 365, 366, 450 dhe 463 të KPPRK-së, të pandehurit i :

### GJ Y K O N

1. [REDACTED]

Denohet me DENIM ME ME GJOBË në shumën prej 150 eurove (me shkronja:Njëqind e pesdhjet euro), të cilin gjobë i pandehuri do ta paguaj pasi i që aktgjykimi të merr formën e prerë.

2. [REDACTED]

Denohet me DENIM ME ME GJOBË në shumën prej 150 eurove (me shkronja:Njëqind e pesdhjet euro), të cilin gjobë i pandehuri do ta paguaj pasi i që aktgjykimi të merr formën e prerë.

2. [REDACTED]

Denohet me DENIM ME ME GJOBË në shumën prej 150 eurove (me shkronja:Njëqind e pesdhjet euro), të cilin gjobë i pandehuri do ta paguaj pasi i që aktgjykimi të merr formën e prerë.

Nëse të denuarit nuk dëshirojnë ose nuk munden ta paguajnë gjobën e shqiptuar me këtë aktgjykim, konform nenit 46 par.3 të KPRK-së, të akuzuarit do ta vuajnë denimin, me burg ashtu që për çdo 20 euro të denimit të shqiptuar do të vuajnë secili veq e veq nga 1 (një) ditë burgu pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I dëmtuari [REDACTED] nga Fshati [REDACTED] Komuna e Shtimës , për realizimin e kërkesës pasuror juridike udhëzohet në kontest civil.

Obligohen të pandehurit [REDACTED], [REDACTED] dhe [REDACTED] që në emër të shpenzimeve të procedurës penale solidarisht të paguajnë shumën prej 20 € dhe secili veq e veq shumën prej nga 20 euro në emër të shpenzieve të pashallit gjyqësor në afat prej 15 ditëve, nga data kur aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Konform nenit 39 par.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimate të Krimít –Ligi nr.05/L-036, Obligohet të akuzuart që në emër të Taksës për Kompensimin e Viktimate të Krimít të paguajnë shumën prej 30 eurove, në afat prej 15 ditëve, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

### **A r s y e t i m i**

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzë PP/II nr.47-4/2016 të dt.25.04.2017, i ka ngarkuar të pandehurit, 1. [REDACTED], 2. [REDACTED] dhe 3. [REDACTED] që të tre nga Ferizaji, Rruga “[REDACTED]” nr.[REDACTED], për shkak të veprës penale në bashkëkryerje lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së .

Gjkata, duke vepruar sipas aktakuzës së PTH-së, me datën 25.04.2018, mbajti shqytimin fillestar ku prezentuan prokurori i shtetit Valdet Avdiu, i pandehuri, kurse prezenca e të dëmtuarit në shqyrtim fillestar sipas ligjit nuk kërkohet dhe i njejtë nuk ka prezentuar në shqyrtim gjyqësor.

Konform nenit 246 të KPPRK-së të pandehurit pasi që i janë dhënë udhëzimet nga ana e gjyqtarit gjatë shqyrtimit fillestar përkitazi me pranimin e fajsisë, të akuzuarit: 1. [REDACTED].

2. [REDACTED] dhe 3. [REDACTED] që të tre nga Ferizaji e kanë pranuar fajësinë sipas aktakuzës për veprën penale që i ngarkon prokurori i shtetit.

Në vlerësimin e pranimit të fajësisë së të pandehurit gjyqtari gjykues konform nenit 248 par.2 të KPPRK-së ka kërkuar edhe mendimin e prokurorit të shtetit dhe mbrojtësit të pandehurit, përkitazi me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, ashtu që prokurori i shtetit, është pajtuar me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit të cilët kanë deklaruar se mundë të shkohet me shqiptimin e dënimit.

Gjyqtari gjykues ka vlerësuar se kërkesat nga nenii 248 paragrafi 1 i KPPRK-së janë përmbytshur, pasi që:

- Të pandehurit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë,
- Pranimi është bërë vullnetarisht,
- Pranimi mbështetet në prova dhe faktë të çështjes penale që përban aktakuza dhe materialet e prezantuara nga ana e prokurorit të shtetit me aktakuzë dhe ate: Ekspertiza mjekore ligjore e dt. 19.09.2016, deklarat e të dëmtuarit dhe pandehurve, Raporti mjekësor i Qendrës Emergjente të Spitalit të Ferizajt me nr. 01722 e dt. 04.01.2016,
- akuza nuk përban asnjë shkelje ligjore ose gabime faktike, rrashtu të akuzuarit janë udhëzuar nga ana e gjyqtarit gjykues edhe konform nenit 383 par.2 të KPPRK-së, përkitazi me të drejtën e ankesës vetëm për sankcionin penal, por jo edhe për shkak të gjendjes faktike, si dhe
- Konform nenit 257 të KPPRK-së, aktakuza nuk ka prova të pa pranuesheme.

Të akuzuarit 1. [REDACTED], 2. [REDACTED] dhe 3. [REDACTED] që të tre nga Ferizaji në shqyrtimin fillestar në fjalën e tyre në kuptim të mbrojtjes njësoj kanë deklaruar, pasi e kanë pranuar fajësinë lidhur me veprën penale që i ngarkon prokuroria janë penduar thellë për atë që e kanë kryer, por theksojnë se nuk kanë mundur ti kontrollojnë veprimet e veta në atë moment nga se i dëmtuari u ka pasur borgj dhe kanë pasur çështje të pa zgjidhura me te sa i përket bartjes së pronësisë etj, i kanë premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsëris vepër penale është hera e pare që bien në konflikt me ligjin, kërkojnë falje për këtë veprim të vetin janë të pa punë dhe familjarët e tyre të cilët varen prej tyre dhe i kanë propozuar gjykates që me rastin e matjes së denimit si rrëthana letësuese ti ketë theksësimet e sipër thekësuara nga të akuzuarit.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit kanë egzistuara të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të cilat e përbëjnë figureën e veprës penale penale në bashkëkryerje lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së .

(*Nëse i pandehuri në shqyrtimin fillestar pranon fajësinë dhe Kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mund të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënimit duke mos administruar fare prov, pa plotësuar trupin gjykues dhe pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësor, si dhe pa paraqitur fare fjalë përfundimtare, lidhur me këtë shih Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës të evidentuar si GJA.nr.207/13 të dt.19.03.2013).*

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasyshë të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPRK-së të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, si rrethana lehtësuese mori se të pandehurit të gjithë njësoj e kanë pranuar fajsinë në shqyrtimin fillestar gjyqësor, nuk ka të dhëna se me herët të kenë qenë të dënuar me aktgjykim të formës së prerë për vepra penale, pendesën per vepren e kryer, kanë kërkuar falje për veprimet e ndërrmarrura , i akuzuari i parë është i martuar me 4 fëmijë që varen nga puna e tij, i kanë premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsërisin vepra penale, duke qenë e bindur se ne rastin konkret qëllimi i dënimit mund të arrihet, dhe një dënnimi i tillë është në proporcion me peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurve dhe rrethanave të kryerjes.

Mbi bazën e këtyre rrethanave gjykata vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurve, dhe rrëzikshmerinë konkrete të veprës penale në kuptim të gjitha këtyre rrethanave duke iu caktuar secilit veq e veq denim më të butë dhe ate denim me gjobë në lartësi prej nga 150 eurove.

Nëse të denuarit nuk e paguanjnë gjobën e shqiptuar me këtë aktgjykim, konform nenit 46 par.2 të KPRK-së, të akuzuarit do ta vuajnë denimin, me burg ashtu që për çdo 20 euro të denimit të shqiptuar do të vuaj 1 (një) ditë burgu pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

6

Mbështetur në nenin 450 dhe 451 të KPPK-së: Obligohen të pandehurit [REDACTED] dhe [REDACTED] që në emër të shpenzimeve të procedurës penale solidarisht të paguajnë shumën prej 20 € dhe secili vëq e vëq shumën prej nga 20 euro në emër të shpenzieve të pashallit gjyqësor në afat prej 15 ditëve, nga data kur aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Konform nenit 39 par.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimate të Krimit –Ligji nr.05/L-036, Obligohet të akuzuart që në emër të Taksës për Kompensimin e Viktimate të Krimit të paguajnë shumën prej 30 eurove, në afat prej 15 ditëve, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Konform nenit 463 par.2 të KPPRK-së i dëmtuarit [REDACTED] nga Fshati [REDACTED] Komuna e Shtimës për realizimin e kërkesës pasuror juridike udhëzohet në kontest civil.

Nga sa u theksua ma lart gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ,**


**P.nr.1063/2017 të dt.25.04.2018**

Zyrtari ligjor,

Gazmend Bytyqi

Gjyqtari,

Elmaz Zenuni



**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi lejohet ankesa në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi Gjykates së Apelit në Prishtinë, ankesa dorëzohet nëpërmes kësaj gjykate.